**VENDIM**
**Nr. 56, datë 27.1.2016**

# PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME, PËR MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE, SI PASOJË E SITUATËS EMERGJENTE TË KRIJUAR NGA RRËSHQITJA E TOKËS, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE FARKË, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", dhe të shkronjës "dh", të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, "Për emergjencat civile", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, t'i shtohet fondi prej 30 023 451 (tridhjetë milionë e njëzet e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekësh, për Bashkinë Tiranë, për marrjen e masave parandaluese, si pasojë e situatës emergjente të krijuar nga rrëshqitja e tokës, në njësinë administrative Farkë, në zonën pranë Xhamisë së Selitës, nga reshjet e datës 22.11.2015.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit të vitit 2016.
3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama